



Pranuar / Dorezuar Primiheq/Prodato Received/Delivered	09.12.2020	viti god year	0
Organ /Njësia Org /Jedinka Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3047/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.321/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.321/2020 të datës 27.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi rruga "Sami Frashër" Nr.2 lagjja Dardani, Komuna e Pejës, kundër vendimit Nr. 01/112/01-19715 të datës 29.09.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Pejës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe Nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.12.2020 mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën A.Nr.321/2020 të datës 27.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], ka aplikuar në konkursin publik të shpallur nga Komuna e Pejës me datën 02.07.2020 në pozitën "Zyrtar për Emergjencë I", në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, me numër reference 01-111/01-0056276/20, 5.1- RN000006086 i autorizuar me datë 26.06.2020 nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil.

Ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë dhe ka marrë pjesë në të gjitha fazat e rekrutimit, respektivisht në testim me shkrim dhe intervistë me gojë.

Me datën 14.08.2020 Kryetari i Komunës së Pejës, ka nxjerrë Vendimin Nr. Prot. 01-112/01-74512, për aprovimin e raportit final të rekomanduar nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, për kandidatët e përzgjedhur sipas konkursit të datës 02.07.2020, Nr. Ref.111/01-0056276/20, duke përfshirë dhe pozitën: "Zyrtar për Emergjencë I", në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, me kandidatin e suksesshëm [REDACTED].

Ankuesi, i pakënaqur me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshme, me datën 01.09.2020 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot.01/112/01-79715 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës, i cili më datë 29.09.2020 me Vendimin Nr. 001/112/01-19715, ka aprovuar ankesën e ankuesit [REDAKTUAR] dhe ka shfuqizuar pikën 5 të Vendimit nr.01-112/01-74512 të datës 14.08.2020 për aprovimin e raportit final të Komisionit përzgjedhës për pozitën 'Zyrtar për Emergjencë I'

Me datë 06.10.2020 Kryetari i Komunës, për zbatimin e Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës, ka nxjerrë Vendimin numër 01-118/020092489/20, me të cilin ka ndërprerë marrëdhënien e punës për kandidatin e përzgjedhur gjegjësisht [REDAKTUAR] për pozitën: "Zyrtar për Emergjencë I", në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Ankuesi, me datë 27.10.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHC) me numër protokolli 2275/2020, kundër Vendimit Nr. 02/112/01-19715 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.11.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës, e me datë 16.11.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me provat e lëndës.

Kolegji, për vërtetimin plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe vendosje meritorë të çështjes, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2270/2020 të datës 27.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i MAP-it i datës 26.06.2020; Vendimi i datës 26.07.2020 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës; Kopja e konkursit me nr.01-111/01-0056276/20 i datës 02.07.2020; Vendimi Nr. 02/112/01-19715 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës i datës 29.09.2020; Kërkesë për qasje në dokumente Publike-Zyrtare e datës 27.08.2020; Kopja e testit me shkrim e datës 29.07.2020; Lista e aplikacioneve të pranuar; Procesverbal i Komisionit Përzgjedhës i datës 13.07.2020; Vendimi i datës 14.08.2020 i Kryetarit të Komunës së Pejës; Vendim i datës 06.10.2020 i Kryetarit të Komunës së Pejës; Kërkesë për informatë zyrtare i datës 27.08.2020 nga [REDAKTUAR] Ankesë e datës 01.09.2020nr, 79715 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Letër referencë e datës 08.07.2020; Letër referencë e datës 08.07.2020; Diplomë Universitare e ankuesit e datës 22.11.2011; Diplomë e Mastarit e datës 25.10.2016; Certifikata Përgjigje e datës 16.11.2020; Regjistrimi i aplikacioneve, Lista e ngushtë, kopje-Testi me shkrim, Procesverbali i datës 13.07.2020; Njoftimi i datës 14.08.2020mbi rezultatin e përzgjedhje për punë; Shënim zyrtar i datës 27.08.2020; dy Fletë-dorëzime të datës 24.07.2020; Kërkesë për punësim i datës 13.07.2020 [REDAKTUAR] Vërtetimi Policisë së Kosovës; Vërtetim shkurt -nëntor 2019; Certifikatë; Diplomë Universitetit "Kristal" i datës 30.09.2013 i datës; Vërtetim i datës 30.09.2013; Trusti nga data 01.01.2002 deri me datës 28.08.2020; Kërkesë për punësim e datës 13.07.2020; Vërtetime nga Noteri numër LRP-nr. rendor 4153/2020; Letër referencë e datës 08.07.2020; Certifikata; Vlerësim i datës 27.11.2017 nga Ministria e Shëndetësisë; E-mail zyrtar i datës 05.12.2020 provë shtesë nga Komuna e Pejës; Vërtetimi datës 02.10.2020.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shtjelluar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për përfundim të procedimit administrativ të iniciuar nga ankuesi [REDACTED] [REDACTED] përmes parashtrimit të ankesës A.Nr. 321/2020 të datës 27.10.2020, *sepse*,

Kolegji, shqyrtoj pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se procedura me rastin e përzgjedhjes se [REDACTED] [REDACTED] në pozitën: "Zyrtar për Emergjencë I", duke kërkuar shfuqizimin e pikës pesë (5) të Vendimit 01-112/01-74512 të datës 14.08.2020 si dhe obligimin e Zyrës së Personelit që të rihap konkurs për pozitën e zyrtarit për emergjencë dhe të njoftoj [REDACTED] se nuk ka fituar të drejtën e punësimit.

Kolegji, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka konstatuar se objekti i ankesës me të cilin ka filluar procedimi administrativ, është i njëjtë me atë për të cilin ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 01.09.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës (KZKA), lidhur me të cilën KZKA-ja me vendim Nr.01118/020092489/20 të datës 29.09.2020 ka aprovuar pretendimet ankimore të ankuesit duke shfuqizuar vendimin e datës 13.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Pejës, lidhur pozitën "Zyrtar për Emergjencë I".

Andaj, duke marrë parasysh se qëllimi për të cilin ankuesi ka iniciuar ankesë në Këshill, është realizuar në procedurën e ankesës pranë organit të punësimit, Kolegji bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative përkatësisht bazuar në Nenin 104 të këtij Ligji ku thuhet "**Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot**", ka konstatuar që të përfundohet procedimi administrativ i iniciuar nga ankuesi [REDACTED] [REDACTED] me anë të ankesës A.nr.321/2020 të datës 27.10.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, bazuar në Nenin 97 pargraf 3 të Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 321/2020.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMShCK

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

Kryetare e Kolegjit